

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY RELATED MATTERS	SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

SCEL – 10 – 0014

Ankuesit

1. **B.B.**
2. **Z.P.**
3. **R.K.**
- 4/1. **H.H.**
- 4/2. **D.M.**
5. **B.S.**
6. **S.Š.**

Kundër

E Paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevcı nr. 8, Prishtinë

Kolegji nr. 1 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga Paulo Ferreira Rijo Gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Çerim Fazliji, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12.06.2013, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. **Ankesat e ankuesve Z.P. (C2), R.K. (C3) dhe S.Sh. (C6) aprovoen si të bazuara. Ata do të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejtë në një pjese të të ardhurave nga privatizimi i N.Sh-së.**
2. **Ankesat e ankuesve B.B. (C1), H.H. (C4/1) dhe D.M. (C4/2), refuzohen si të pa bazuara.**
3. **Ankesa e ankuesit B.S. (C/5) hedhet poshtë si e papranueshme.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Ankuesit pretendojnë se janë ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore NSH “K.B.”, në D. e cila është privatizuar nga e Paditura, me datë 22 Nëntor 2006.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime është publikuar me datat 02. 03, dhe 04 Shtator 2010 në mjetet e informimit publik në gjuhën Shqipe “ Kosova Sot” dhe “ Koha Ditore” si dhe është bërë publikimi në gazetën në gjuhën Serbe “ Blic” dhe gazetën Malazeze “ Vjesti” nga Podgorica (Mali Zi) me data 01, 02 dhe 04 Shtator 2010 dhe se afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ka qenë data 27.09.2010.

Me 21.09.2010, B.B. (**ankuesi C1**) parashtrojë një ankesë DHPGJS të Kosovës, kundër AKP-së e cila administron me NSH “ K.B.” në D., për shkak të mos përfshirjes së tij në listën e përfituesve të 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje. Ai kërkonte që DHP ta obligojë AKP-në që ta vendosë atë në listën përfundimtare të përfituesve. Ankuesi thekson se ishte në marrëdhënie pune në këtë ndërmarrje nga 20.01.1981 deri me 31.01.1992, kur përmes një vendimi të lëshuar nga organet e atëhershme të dhunshme administrative Serbe në Kosovë, ishte larguar në mënyrë arbitrare nga vendi i tij i punës ku ishte në cilësinë e Drejtorit të NSH. Pas përfundimit të luftës konkretisht me 29.07.1999, ai sërish ishte emëruar në cilësinë e Drejtorit të kësaj NSH, mirëpo me datën 31.07.2004, në mënyrë vullnetare kishte shkëputur marrëdhënien e punës në këtë ndërmarrje për arsye të themelimit të marrëdhënies së punës në Ministrinë e Bujqësisë. Ankuesi ka bashkangjitur: Vendimin mbi emërimin e marrëdhënies së punës në NSH me nr. 02-7 të datës 16.02.2004, si dhe certifikatën mbi provojnë e punës në N.SH nr. 02-25 të datës 10.05.2004.

Më 04.10.2010 AKP në përgjigjen e saj ndaj urdhrin të DHP, përkitazi me ankesën , thekson se ankuesi nuk i plotëson kriteret ligjore sipas nenit 10 paragrafi 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut me nr. 2003/13 sepse parashtruesi i ankesës ka prezantuar kopjen e pavërtetuar të vendimit për emërimin e tij në këtë ndërmarrje si dhe kopjen e pavërtetuar të certifikatës të lëshuar nga NSH, dhe se parashtruesi në kohën e privatizimit të kësaj ndërmarrjeje nuk ishte në marrëdhënie pune në këtë NSH pasi që ai kishte shkëputur marrëdhënien e punës me datën 31.07.2004 dhe kishte filluar punë në Ministrinë e Bujqësisë, andaj kanë propozuar që ankesën e tij ta refuzohet si e pabazuar.

Me 22.09.2010, Z.P. (**ankuesja C2**) parashtrojë një ankesë DHPGJS të Kosovës, kundër AKP-së e cila administron me NSH “ K.B.” D., për shkak të mos përfshirjes së saj në listën e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të kësaj ndërmarrjeje me kërkesë që DHP atë ta vendosë në listën e përfituesve. Ankuesja theksoj se ishte në marrëdhënie pune nga viti 1992 deri kur ajo ishte larguar nga Kosova. Ajo parashtrojë dokumentet si në vijim: librezën e punës 15168, Aktvendimin e organit të përkohshëm administrativ me nr. 02-421 të dt. 21.07.1992, si dhe dokumentin e identifikimit. Ajo thekson se AKP e kishte hedhur poshtë ankesën e saj si të paafatëshme . Ankuesja pohon se lufta ishte një gjendje e veçantë që ajo nuk ishte me në punë.

Më 04.10.2010 AKP parashtroj përgjegje në urdhrin e DHP, përkitazi me ankesën duke theksuar se ankuesja nuk i plotëson kriteret ligjore të paraparë në nenin 64.2 të Ligjit për Procedurë Administrative 2006/17, pasi që ajo nuk e ka parashtruar ankesën ndaj listës së përkohshme deri me 12.10.2007, ankesa e saj është e paafatëshme , dhe propozoj DHP që këtë ankesë ta hedhë poshtë si të papranueshme.

Me datën 23.09.2010, R.K. (**ankuesi C3**) parashtrojë një ankesë DHPGJS të Kosovës, kundër AKP-së e cila administron me NSH “ K.B.” D., për shkak të mos përfshirjes së tij në listën e përfituesve të 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, duke kërkuar nga DHP që ta obligojë AKP-në që ta vendosë ankuesin në listën e përfituesve. Ankuesi në pretendimet e tij ankimore thekson se kishte qenë në marrëdhënie pune në këtë ndërmarrje nga 1963 e deri me 1992, kur përmes një vendimi të lëshuar nga organet e atëhershme të dhunshme administrative Serbe në

Kosovë, në mënyrë arbitrare ishte larguar nga vendi i punës. Ankuesi duke i mbështetur pretendimet e tij ankimore thekson se të gjitha dokumentet e parashtruara nga ana e tij në DHP janë autentike dhe relevante dhe se vërtetojnë pohimet e tij në ankesë, dhe në bazë të dokumentacionit të cilin disponon do të duhej të ishte përfshirë në listën e përfituesve nga privatizimi i kësaj NSH, pasi që ai kishte punuar në këtë ndërmarrje deri me datë 11.05.2007.

Ai ka bashkangjitur: Vërtetimi mbi përvojën e punës në NSH, i lëshuar nga K.B. në D. me nr. 6 i dt. 31.01.2008, librezën e punës nr. 2347.

Me 01.10.2010 AKP i përgjegjet urdhrin të DHP, dhe thekson se ankuesi nuk i plotëson kriteret ligjore të paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut me nr. 2003/13, neni 10 paragrafi 10.4 sepse në kohën e privatizimit të kësaj NSH ankuesi ndodhej në moshën e pensionimit, andaj AKP i propozoj DHP që ankesën e tij ta refuzojë si të pabazuar.

Me 28.09.2010, H.H. (**ankuesi C4/1**) dhe D.M. (**ankuesi C4/2**) parashtruan një ankesë DHP, kundër AKP-së e cila administron me NSH “K.B.” D., për shkak të mos përfshirjes së tyre në listën e përfituesve të 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, me kërkesë që të obligojë AKP-në që ti vendosë ankuesit në listën përfundimtare. Ankuesit në pretendimet e tyre ankimore theksuan se ata ishin punëtorë të kësaj N.SH dhe bashkangjiten një Ekstrakt të Kuvendit të K.B. i dt. 20.11.2003.

Më 07.10.2010 AKP në përgjegjen ndaj urdhrin të DHP, përkitazi me ankesat e ankuesve (C4/1) dhe (C4/2), thekson se ankuesit nuk i plotësojnë kriteret ligjore të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut me nr. 2003/13, neni 10 paragrafi 10.4 sepse nuk kanë parashtruar prova relevante për të vërtetuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës, dhe se nuk ishin të regjistruar si punëtor të N.SH në kohën e Privatizimit. AKP ka propozuar që ankesat e tyre ti refuzohen si të pabazuara.

Me 04.10.2010, B.S. (**ankuesi C5**) parashtrojë një ankesë DHPGJS të Kosovës, kundër AKP-së e cila administron me NSH “K.B.” D., për shkak të mos përfshirjes së tij në listën e përfituesve të 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, me kërkesë që ta obligojë AKP-në që ankuesin ta vendosë në listën e përfituesve. Ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore parashtrojë këto dokumente: kopjen e librezës së punës me nr. 1309/83, kopjen e aktvendimit mbi sistematizimin në punë me nr. 02-446 të dt. 29.08.1992, si dhe kopjen e dokumentit të identifikimit.

Më 15.10.2010, AKP në përgjegjen ndaj urdhrin të DHP, përkitazi me ankesën thekson se ankuesi nuk i plotëson kriteret ligjore të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut me nr. 2003/13, neni 10 paragrafi 10.4 sepse gjatë kohës së privatizimit të kësaj NSH ankuesi nuk figuronte në listën e punëtorëve të kësaj NSH, andaj AKP i propozon DHP që ankesën e tij ta refuzojë si të pabazuar.

Më 27.09.2010, S.Š. (**ankuesja C6**) parashtrojë një ankesë DHPGJS të Kosovës, kundër AKP-së e cila administron me NSH “K.B.” D., për shkak të mos përfshirjes së saj në listën e përfituesve të 20% nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, me kërkesë që ta obligojë AKP-në që ankuesen ta vendosë në listën e përfituesve të 20%. Ankuesja theksoj se ishte në marrdhenje pune nga viti 1989 deri kur ajo ishte larguar nga Kosova. Ankuesja në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore i parashtrojë

këto prova: kopjen e librezës së punës me nr. 6334/87 si dhe kopjen e aktvendimit mbi sistematizimin e saj të punës në këtë NSH me nr. 02-69/85 të dt. 25.01/1990.

Me 15.10.2010, AKP në përgjigjen ndaj urdhrin të DHP, përkitazi me ankesën thekson se ankuesja nuk i plotëson kriteret ligjore të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut me nr. 2003/13, neni 10 paragrafi 10.4 sepse është dështuar të parashtrojë prova të mjaftueshme se a ka ndërmarrë çfarëdo pune juridike që të vazhdojë kontinuitetin e marrëdhënjes së punës në këtë NSH pas qershorit të vitit 1999, gjersa dokumentet e tjera të dorëzuara nuk paraqesin prova relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore. Andaj AKP i propozon DHP që ankesën e saj ta refuzojë si të pabazuar.

Më 25.03.2011 ankuesja (C6) përkitazi me përgjegjen e AKP ndaj Urdhrin të lëshuar të Gjykatës, parashtroj kundër-përgjigje ndaj përgjegjes së AKP-së duke shtuar se nuk pajtohet me deklaratimet e AKP-së, pasi asaj nuk i është mbyllur librezë e punës, dhe se si pasojë e luftës në mesin e qershorit 1999 ajo ishte detyruar të largohet nga Kosova. Pas luftës ajo kishte ndërmarrë veprim juridik, që sërish të kthehet në vendin e punës, gjithashtu ajo thekson se nuk i është lëshuar asnjë aktvendim ligjor që të i ndërprehet marrëdhënia e punës, dhe se ajo në bazë të Rregullores së UNMIK-ut me nr. 2003/13 neni 10 paragrafi 10.4 i plotëson kriteret që të përfshihet në listën e përfituesve.

Me 16 dhjetor 2010, AKP është përgjigjur në urdhrin e gjykatës të datës 26 nëntor 2010 dhe ka dërguar një raport të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të datës korrik 2010, një listë të punëtorëve të datës 11 maj 2007, një deklaratë nga drejtori i kompanisë.

Me 3 mars 2011 AKP është përgjigjur në urdhrin e gjykatës të datës 10 shkurt 2011, duke bashkangjitur kopjet e publikimeve në gazetën në gjuhën shqipe, “Koha Sot” dhe “Koha Ditore” me 2, 3 dhe 4 shtator 2010 (e Shtunë) dhe në gazetën në gjuhën serbe “Vijesti” me 1, 2 dhe 4 shtator 2010 dhe “Blic” me 1 dhe 4 shtator 2010. AKP më tej ka deklaruar se ajo është institucion publik dhe se të gjitha dokumentet e saj janë të vërtetuara me vulën e Agjencisë si të vërtetuara nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Arsyetimi ligjor:

Aktgjykimi është marrë pa mbajtur seancë dëgjimore pasi që faktet dhe argumentet ligjore janë deponuar mjaftë qartë. Kolegji nuk pret informacion tjetër relevant dhe argumente tjera në ndonjë seancë dëgjimore. Neni 68.11 i Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme 04/L-033- LDHP).

Ankesat e ankuesëve (C2), (C6) janë të bazuara.

Dështimi i ankuesës (C2) për ta kundërshtuar listën e përkohshme në pajtim me nenin 67.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk e bën ankesën ndaj listës përfundimtare si të papranueshme.

a. Neni 127 i Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nuk është i zbatueshëm. Neni 127 thotë si në vijim:

“Ankimi administrativ

127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës.

127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.

127.3. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.

127.4. Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6, në nenin 70.3 (a) dhe (b) nën titullin “Ligji në fuqi” nuk i referohet Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, por në vend të kësaj i referohet Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, i cili nuk përmban asnjë dispozitë që përshkruan shterimin e të gjitha mjeteve administrative para shkuarjes në gjykatë.

Megjithatë, edhe nëse neni 127 i Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 do të zbatohet, ankuesit nuk do të kishin nevojë që ta kundërshtojnë listën e përkohshme para parashtrimit të ankesës ndaj listës përfundimtare. Padia e tyre nuk ka të bëjë me listën e përkohshme (e cila mund të jetë kundërshtuar), por me listën përfundimtare (ndaj së cilën nuk është e mundur asnjë mjet administrativ).

b. Për më tepër, formulimi i fjalisë së parë të nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që punëtori duhet ta kundërshtojë listën e përkohshme në mënyrë që rrjedhimisht të kualifikohet të ankohet ndaj listës përfundimtare. Fjalitë e parë e nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 thotë si në vijim:

“Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrorë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.”

Ligji nënvizon vetëm të drejtën për të kundërshtuar, e jo obligimin.

c. Kolegji është i vetëdijshëm se obligimi për të kundërshtuar çfarëdo mangësie në listën e përkohshme i kombinuar me sanksionin, që, nëse kjo nuk bëhet, ankesa ndaj listës përfundimtare bëhet e papranueshme, do t'i ndihmonte agjencisë që ta bëjë një listë të saktë përfundimtare brenda një kohe më të shkurtër.

Obligimi për të shteruar mjetet administrative para drejtimit në gjykatë do ta parandalonte palën nga përdorimi i mjeteve juridike pa nevojë.

Procedura e së pari bërjes së listës së përkohshme dhe dhënia e shansit secilit për ta kundërshtuar një listë të tillë dhe për të paraqitur fakte dhe prova brenda 20 ditëve i ndihmon AKP-së për ta bërë listën e saktë përfundimtare pa vonesë të panevojshme. Kjo do të thotë për tu koncentruar dhe për të shpejtuar procedurën. Mbledhja e të gjitha fakteve dhe provave të nevojshme sa më shpejtë që të jetë e mundur është një mjet kyç në kontekstin procedural në të cilin shuma monetare prej 20 për qind e pjesës për secilin punëtor varet nga aktvendimi për pranim dhe refuzim.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk e sanksionon mungesën e bashkëpunimit të punëtorit në fazën e bërjes së listës përfundimtare duke e bërë ankesën ndaj listës përfundimtare të papranueshme (njëjtë: aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCEL-09-0001).

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, përcakton kërkesat që një punëtor duhet t'i plotësojë në mënyrë që të konsiderohet si i kualifikuar, ndërsa neni 10 përcakton procedurën për parashtrimin e ankesës pranë Dhomës së Posaçme si në vijim:

“10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilin pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.”

Ankueset (C2),(C6) ishin larguar nga NSH-ja gjatë luftës pasi që ishte një gjendje e veçantë . Ato nuk ka dërguar dokumente për të vërtetuar faktin se ishin të sulmuara apo diskriminuara. Ato nuk kanë pohuar në detaje asnjë akt të agresionit apo diskriminimit. Megjithatë, as e paditura nuk e ka kontestuar faktin se ato janë larguar prej vendit të tyre nga frika, as nuk ka kundërshtuar se frika e tillë pas përfundimit të luftës ishte arsytuar për personat e kombësisë serbe. Prandaj kjo në procedurën civile mund të merret si fakt mbi të cilin mund të bazohet aktgjykimi dhe nuk ka nevojë për dokumente të tjera apo prova të tjera.

E paditura AKP, nuk kishte kontestuar marrëdhënien e punës së ankuses (C2) pranë NSH-së apo ndonjë fakt tjetër, por ishte fokusuar vetëm në faktin se ankuesja nuk kishte shteruar mjetet e tjera administrative në dispozicion kundër listës së përkohshme, ndërsa ndaj ankuses (C6) kishte kontestuar kontinuitetin e marrëdhënies se punës pas vitit 1999.

Dhe madje edhe nëse e paditura do ta kontestonte diskriminimin, nuk do të ishte barra e ankueseve, por do të ishte barra e të paditurës për të vërtetuar se nuk ka pasur diskriminim.

Nuk u takon punëtorëve që ta vërtetojnë diskriminimin, por i takon të paditurës që të vërtetojë se nuk ka pasur diskriminim. Barra e provave, e cila sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ishte mbi ankuesin, është zhvendosur tek e paditura sipas Ligjit Kundër Diskriminimit Nr. 2004/03.

Neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, lidhur me barrën e provave, thotë si në vijim:

“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”

Neni 11 i Ligjit të njëjtë thotë si në vijim:

“11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji”.

Konflikti në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999 është fakt i njohur nga i cili Gjykata mund të supozoj diskriminimin. Prandaj, kjo do të bëhej barra e të paditurës për të vërtetuar se nuk ka pasur diskriminim, dhe jo barra e ankuesit për të vërtetuar se ka pasur diskriminim (neni 8.1 i Ligjit Kundër Diskriminimit, njëjtë në aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 10 qershor 2011 në lëndën SCEL-09-0001). Andaj, ankesat e ankueseve janë të bazuar (neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13).

Ankesa (C3) është e bazuar

Gjykata konsideron se dëshmitë e paraqitura nga ankuesi (C3) janë të mjaftueshme për të vlerësuar legjitimitetin e tij për tu përfshirë në listën e 20%.

Nga lista e evidencës të librit amzë i të punësuarve në K.B. “D.” nr.02-1, të datës 11 maj 2007, librezat e punës nr. 2347, nga vërtetimi nr.6 të lëshuar nga K.B., si dhe nga deklaratat e drejtorit të kësaj ndërmarrje Gjykata konstatoj se ankuesi ishte i regjistruar dhe kishte punuar në N.SH deri me datën e privatizimit, dhe se atij nuk i ishte mbyllur librezat e punës, edhe pse ishte në moshën e pensionimit.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, i cili përcakton kërkesat që një punëtor duhet t'i plotësojë në mënyrë që të konsiderohet si i kualifikuar nuk parasheh se mosha është pengës për të realizuar 20% nga privatizimi i N.SH.

Ankesat ankuesve (C1),(C4/1), (C4/2), janë të pa bazuara.

Ankuesi (C1) pohoj se kishte shkëputur vullnetarisht marrëdhënien e punës me K.B. në D. me 31.07.2004 dhe se kishte themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Bujqësisë. Pra ankuesi në kohën e privatizimit të ndërmarrjes nuk figuronte në listën e të punësuarve në këtë NSH, prandaj nuk i plotëson kriteret e parapara me Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, në mënyrë që një punëtor të konsiderohet i kualifikuar.

Ankesat e ankuesve (C4/1) dhe (C4/2) ishin të pabazuara dhe se pretendimet e tyre ankimore nuk i mbështeten me prova relevante, siç janë librezat e punës, vendimin mbi marrëdhënien e punës apo ndonjë pagesë mbi të ardhurat personale në kohën e privatizimit të N.SH. Ata paraqiten vetëm një ekstrakt nga procesi i Kuvendit të Koperativës Bujqësore të datës 20.11.2003, mirëpo sipas gjykatës ky dokument nuk

mund të jetë relevant për ta vërtetuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës deri në privatizimin e N.SH-së.

Ankesa e ankuesit (C5), është e papranueshme.

Sipas nenit 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 në lidhje me nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, ankesa kundër listës përfundimtarë duhet të dorëzohet brenda 20 ditëve pas shpalljes së listës përfundimtare.

Publikimi listës përfundimtare të punëtorëve është bërë me datat 02, 03, dhe 04 Shtator 2010 në mjetet e informimit publik në gjuhën Shqipe “ Kosova Sot” dhe “ Koha Ditore” si dhe është bërë publikimi në gazetatat në gjuhën Serbe “ Blic” dhe gazetën Malazeze “ Vijesti” nga Podgorica (Mali Zi) , me data 01, 02 dhe 04 Shtator 2010 dhe se afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ka qenë data 27.09.2010.

Ankuesi paraqiti ankesë pas afatit me 01.10.2010, andaj ankesa e tillë është e papranueshme.

Taksat Gjyqësore:

Gjykata nuk cakton shpenzime për ankuesin sepse këshilli Gjyqësor i Kosovës deri tani nuk ka miratuar një skemë me shkrim të nxjerr nga Presidiumi i Dhomës së Posaçme (neni 57, paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për caktimin e shpenzimeve.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të i parashtrohet Ankesa brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t’u dërgohet edhe palëve tjera dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor nga ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Ankesën tek palët e tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshme nëse ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

E paditura mund të parashtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen e saj tek ankuesi dhe tek palët tjera.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t’i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e tij tek Kolegji i Apelit dhe tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t’i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Paulo Ferreira Rijo, Gjyqtar Kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Ćerim Fazliji, Gjyqtar